



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gjeografi**

Lënda: BAZAT E GJEOLLOGJISË

Pedagogu:	Doc. Dr. Arben BELBA
Ngarkesa:	4 ETCS (15 javë: 2 leksione dhe 1 seminar në javë)
Lloji i lëndës:	e detyrueshme
Viti/semestri:	I/I

Shkurtuesë: Lënda Bazat e Gjeologjisë është pjesë e disciplinave me karakter teorik dhe aplikativ të shkencave të Tokës. Ajo i mundëson studentëve njohuritë bazë mbi fenomenet e proceset fizike që ndodhin nga sipërfaqja e Tokës deri në qendër të saj. Pjesa e parë merret me përbërjen e Tokës dhe vendin e saj në hapësirën qiellore. Toka trajtohet në ndërtimin e saj të brendshëm; shtresat që e përbëjnë dhe veçoritë e tyre fizike e kimike. Mineralet e shkëmbinjtë zenë një vend të rëndësishëm. Mekanizmi i formimit të shkëmbinjve shoqërohet me llojet kryesore të tyre dhe grupimet përkatëse sipas karakteristikave bazë. Në pjesën e dytë parashtrohen proceset që formësojnë sipërfaqen e Tokës; si tjetësimi, erozioni, gëryerja shpatore, së bashku me veprimtarinë gjeologjike të ujrale rrjedhëse, nëntokësore, akullnajave, erës dhe veprimtarisë së ujit të detit dhe oqeanit. Pjesa e tretë mer përsipër të trajtojë dinamikën e zhvillimit të Tokës, me deformimin e shkëmbinjve dhe strukturat gjeologjike; lëkundjet sizmike dhe tërmetet; si dhe tektonikën globale me teoritë kryesore. Në fund ky cikël leksionesh përmbyllët me dinamikën aktuale të ndryshimit të planetit tonë, Tokës, ndryshimet klimatike dhe prespektiva e ndryshimeve globale. Njohuritë gjeologjike janë të domosdoshme, jo vetëm në formimin gjeografik të studentëve, por edhe në ndikimin e zhvillimit të mjaft degë të rëndësishme të ekonomisë dhe zhvillimin e përgjithshëm të vendi.

Temat e leksioneve:

1. Objekti, përmbajtja, detyrat dhe rëndësia e studimit të Gjeologjisë.

Pjesa e parë. Toka dhe vendi i saj në hapësirën qellore. Struktura e brendshme dhe përbërja e Tokës.

2. Mineralet, burimet e mineraleve dhe energjisë.

3. Shkëmbinjtë. Vullkanet, magma dhe shkëmbinjtë magmatikë.

4. Sedimentet, shkëmbinjtë sedimentarë dhe diagjeneza.

5. Krijimi i shkëmbinjve të rinj nga të vjetrit; metamorfizmi dhe shkëmbinjtë metamorfikë.

6. Koha gjeologjike.

7. Pjesa e dytë. Proceset që formësojnë sipërfaqen e Tokës. Tjetërsimi. Erozioni dhe tokat. Gëryerja shpatore.

8. Veprimtaria gjeologjike e ujërave rrjedhëse. Ujrat nëntokësore.

9. Akullnajat dhe akullzimi.

10. Veprimtaria gjeologjike e erës dhe shkretëtirat.

11. Veprimtaria gjeologjike e ujrave të deteve e oqeaneve.

12. Pjesa e tretë. Deformimi i shkëmbinjve, strukturat gjeologjike.

13. Tërmetet dhe lëkundjet sizmike.

14. Tektonika globale.

15. Dinamika e ndryshimit të planetit tonë. Ndryshimet klimatike.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- *Detyrim frekuentimi* në: 70% të seminareve

- *Angazhimi* në *seminare*: 10 % e notës

- *Testi* në javën e 8-të 20 % e notës

- *Detyra e kursit ose ese*: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5): 10 % e notës

- *Kontrolli përfundimtar*: provim me shkrim 60 % e notës

- *Gjithsej*: 100 %

Literatura e detyrueshme për studentin:

1. Trifon Ziu, *Bazat e Gjeologjisë*, Pegi, Tiranë 2014.
2. Luan Peza & Pajtim Bejtja, *Gjeologjia e përgjithshme*, Shtypshkronja Dispenca, Tiranë 1983.
3. Koço Prifti & Pajtim Bejtja. *Gjeologjia e përgjithshme*, Tiranë, 1996

Literatura plotësuese:

1. Brian J. Skinner & Stephen C. Porter, *The Dynamic Earth an introduction to physical geology*, Von Hoffman Press, Inc, USA 1992
2. H.J de Blij & Peter O. Muller, *Physical Geography of the global environment*, Von Hoffman Press, Inc, USA 1993
3. Servet Pasho, *Bazat e Gjeologjisë*, Tiranë, 1972
4. Adem Dalipi, *Gjeologjia e përgjithshme*, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, 1974
5. Selam Meço, *Tabela Gjeokronologjike*, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, 1985
6. Koço Prifti & Eftim Dodona & Aleks Vranaj, *Bazat e Gjeologjisë*, Tiranë, 1989
7. Skënder Dede, *Pasuritë minerale të Shqipërisë*, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, 1980.
8. Shallo M, Kote Dh, *Petrologjia magmatike dhe metamorfike*, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, 1990.